

AKT THEMELIMI

i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar

"PARAGON" SH.P.K

Në Tiranë, sot më datë 01.10.2022, Z. Klodjan Bregu, shtetas shqiptar, lindur në Leshnje, Skrapar, më 30.03.1981, mbajtës i kartës së identitetit nr. 036142856, ortak i vetëm themelues i shoqërisë "PARAGON" sh.p.k. me zotësi të plote juridike për të vepruar, harton këtë Akt Themelimi të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "PARAGON" SH.P.K

Neni 1

Baza juridike

Shoqëria krijohet dhe ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me ligjin Nr.9901, datë 14.04.2008, "Per Tregtarët dhe Shoqërite Tregtare", si dhe në përputhje me dispozitat e Statutit dhe Aktit të Themelimit të saj.

Neni 2

Forma e shoqërisë

Shoqëria e themeluar do të jetë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, SH.P.K

Neni 3

Emërtimi i shoqërisë

Emërtimi i Shoqërisë është "PARAGON" SH.P.K

Neni 4

Selia e Shoqërisë

Selia e Shoqërisë "PARAGON" SH.P.K ndodhet në adresën: Rruga "Tre vellezërit Kondi", Apartamenti Nr. 24, Zona Kadastrale Nr. 8190, Numri i Pasurisë 15/412+1-24, Volumi 13, Faqe 208, Tiranë, Shqipëri.

Neni 5

Objekti i veprimtarisë

Shoqëria tregtare mund të ushtrojë çdo veprimtari e cila nuk ndalohet me ligj. Objekti i aktivitetit është i përgjithshëm.

Ai përfshin veprimtari të mëposhtme, por nuk kufizohet në to, si:



Shërbime këshillimi në sipërmarrje, menaxhim dhe administrim, për projekte dhe biznese, për individë dhe subjekte, publikë shtetërorë dhe privatë, shoqëri tregtare dhe OJF, vendas dhe të huaj. Analiza, studime fizibiliteti dhe hartimi i planeve të biznesit. Mbështetje për krijimin dhe regjistrimin e shoqërive tregtare dhe OJF-ve, të çdo forme ligjore. Ekzaminimi dhe vlerësimi i biznesit, si dhe hartimi i planeve të përmirësimit për të qënë më konkurrues. Hartimi, implementimi dhe menaxhimi i projekteve në fusha të ndryshme. Trajnime të ndryshme në menaxhim projektesh, sipërmarrje, menaxhim biznesi, ngritje kapacitetesh, etj.

Ushtrimin e çdo veprimtarie tjetër ekonomike, duke përfshirë, por pa u kufizuar: blerjen, shitjen, marrjen dhe dhënien me qira, menaxhimin dhe zhvillimin e pasurive të patundshme; ofrimin e produkteve dhe shërbimeve të ndryshme në fushën e edukimit duke përfshirë të gjitha ciklet e formimit dhe arsimit, nga ai parashkollor deri në atë universitar; në fushën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit-ICT; projektimin dhe zbatimin e impianteve elektrike dhe hidromekanike; zhvillimin, projektimin dhe ndërtimin e objekteve civile dhe industriale; në fushën e turizmit dhe mikpritjes; import-eksport dhe tregtimin e mallrave dhe shërbimeve të ndryshëm me shumicë dhe pakicë, brenda dhe jashtë vendit; pjesëmarrjen në tenderat publikë, apo privatë duke ofruar mallra dhe shërbime të ndryshme.

Neni 6 Kohëzgjatja

Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë për një periudhë të pacaktuar kohore, duke filluar nga momenti i regjistrimit të saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit, Tiranë.

Neni 7 Kapitali i shoqërisë

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100,000 (njëqind mijë) Lekë. Ortaku i vetëm themelues i shoqërisë Z. Klodjan Bregu, zotëron 1 (një) kuotë me vlerë të përgjithshme 100,000 (njëqind mijë) Lekë, që përbën 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Neni 8 Administrimi

Administrator i shoqërisë dhe njëkohesisht ortak i vetëm i saj është Z. Klodjan Bregu, shtetas shqiptar, lindur në Leshnje, Skrapar, më 30.03.1981, mbajtës i kartës së identitetit nr. 036142856.

Mandati i administratorit është për një periudhë 5 vjeçare sipas ligjit. Ortaku i vetëm mund të vendosë të caktojë një Administrator të ri sipas mënyrës së parashikuar në ligj në çdo kohë dhe për çdo shkak të arsyeshëm.



Ky Akt Themelimi u hartua në tre kopje origjinale, në gjuhën shqipe.

**ORTAKU I VETËM THEMELUES
I SHOQERISË "PARAGON" SH.P.K
Z. KLODJAN BREGU**

A handwritten signature in blue ink that reads "Klodian Bregu". The signature is written in a cursive style with a long horizontal stroke at the beginning.A second handwritten signature in blue ink, which is a stylized and more compact version of the name "Klodian Bregu". It is enclosed within a large, hand-drawn oval.